

**VENDIM**  
**Nr. 11, datë 11.1.2024**

**PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-S, “AEGEAN SEA”, NË DETIN EGJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dërgimin me mision të 1 (një) anijeje të klasit “Iliria”, e përbërë nga 22 (njëzet e dy) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e NATO-s “*Aegean Sea*”, në detin Egje.

2. Misioni i anijes është kryerja e patrullimit detar në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, *Standing NATO Maritime Group-2* (SNMG2), në detin Egje, në kuadër të aktivitetit të NATO-s, në detin Egje.

3. Komandimi operacional i anijes gjatë periudhës së angazhimit në mision kryhet nga komandanti i grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2, në detin Egje. Për çdo rast, anija ruan varësinë në nivelin kombëtar, duke raportuar në mënyrë periodike për mbarëvajtjen e misionit.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Afati i llogaritjes së ditëve të qëndrimit në mision për çdo anije është çdo 6 (gjashtë) muaj, me rotacion. Afati i qëndrimit të personelit në mision është 90 (nëntëdhjetë) ditë, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrje dhe dorëzim detyre, vonesa të transportit strategjik etj. Ditët e qëndrimit të personelit në mision llogariten nga dita e nisjes për në mision deri në ditën e kthimit në atdhe.

5. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqimin;

ç) sigurimin e anijes;

d) sigurimin e pajisjeve të komunikimit të sigurt me NATO-n;

dh) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

e) siguracionin shëndetësor për ditët e udhëtimit;

ë) transportin;

f) mbështetjen shëndetësore;

g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

gj) karburant, lubrifikant;

h) transportimin e individëve të shkëputura nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare gjatë kohës së kryerjes së misionit;

j) taksa portuale dhe shërbime portuale;

k) riparimin e nivelit III, pas kthimit të anijes nga misioni;

l) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transportimi i personelit të anijes që merr pjesë në mision, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transportimi i individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, përballohen nga pala shqiptare, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër të marrë përsipër këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**